



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "MAX TV"
Nr. i biznesit 70880954
Drejtor – Selami DURMISHI
Pronar
Selami DURMISHI dhe Valdet ARUQI
Rr/ Ilaz Kodra, pn
Skenderaj

"MAX TV" SH.P.K
Nr. i biznesit 71350703
Drejtor – Selami DURMISHI
Pronar
Selami DURMISHI dhe Valdet ARUQI
Rr/ Ilaz Kodra, pn
Skenderaj

Ref:1709/1068/LIC/ni

VENDIM

për ndryshimin e licencës të operatorit të shpërndarjes N.SH. MAX TV në "MAX TV" SH.P.K.

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. N.SH. MAX TV është Operatorë i Shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me Rregullorën KPM – 2016/01. MAX TV është pajisur me licencë të KPM-së më datën 26 nëntor 2014.
3. Më datën 23 mars 2017, pronari i N.SH. MAX TV, ka dorzuar një kërkesë në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka kërkuar ndryshimin e licencës së Operatorit të Shpërndarjes N.SH. MAX TV, nga biznesi Ortakëri e Përgjithshme N.SH. MAX TV me numër të biznesit 70880954, në biznesin si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar "MAX TV" SH.P.K. me numër të biznesit 71350703, për arsye të ndryshimit të llojit të biznesit.

Arsyetimi

4. Pronari i operatorit të shpërndarjes N.SH. MAX TV ka theksuar se, arsyeja e kësaj kërkesë për ndryshim të licencës është ndryshimi i llojit të biznesit duke kaluar nga biznesi Ortakëri e Përgjithshme në biznesin si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

1/2

5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: “licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”.
6. Komisioni konstaton se, pala e interesuar ka dorzuar dokumentet dhe informacionet e nevojshme lidhur me kërkesën për ndryshimin dhe bartjen e licencës. Gjthashtu, Parashtruesi i kërkesës ka kryer edhe pagesën e tarifës administrative për ndryshime në licencë, në vlerë prej njëqind (100) eurove, në pajtueshmeri me Rregulloren për Tarifën Vjetore të Licencës (KPM -2017/03).
7. Komisioni e konsideron si të mjaftueshëm arsyetimin për ndryshimin dhe bartjen e licencës dhe si e tillë, kërkesa i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

8. Komisioni i në takimin e tij të mbajtur me datën 22 shtator 2017, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e licencës së Operatorit Kabllorë N.SH. MAX TV, sipas ndryshimeve në çertifikatën e biznesit, nga Ortakëri e Përgjithshme N.SH. MAX TV me numër të biznesit 70880954, në biznesin si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar “MAX TV” SH.P.K. me numër të biznesit 71350703.

Lëshimi i Vendimit

9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



26.09.2017

datë